REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TROPOJE**

**KRYETARI**

Nr.5101 prot. B.Curri, më 24.10.2025

**Lënda**: Dërgim Projekt Vendimi, Për shpallje "Qytetar Nderi"

**Këshillit Bashkiak Tropojë**

Të nderuar Këshilltar po ju dërgojmë Projekt Vendimin për shpallje "Qytetar Nderi" .

Bashkangjitur kësaj shkrese do të gjeni

1- Projekt Vendimin 1 (një) faqe

2- Jeteshkrimin i Z. Rrustem Mulosmani 1 (një) faqe.

3 – Jeteshkrimi i Z. Lulzim Logu 5 (pesë) faqe.

4- Jeteshkrim i Z. Feriz Lamaj 1 (një) faqe.

Duke ju falendëruar për bashkëpunimin !

KRYETARI I BASHKISË
Rexhe BYBERI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - ... OPOJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 5101/1 Prot

**BASHKIA TROPOJE**

**KRYETARI**

Dt 24.10.2025

**P/VENDIM**

**Nr __ Date ___.___.2025**

**"PER SHPALLJEN QYTETAR NDERI"**

Në përmbushje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 germa "m", Ligjit Nr 94/2022 "Për titujt e Nderit dhe titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", i propozoj Këshillit Bashkiak Tropojë

**V E N D O S I :**

1. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" z.**Rrustem Bajram Mulosmani**, *me motivacion* "Per merita e kontribut te spikatur me punen e drejtimin e tij ne zhvillimin dhe perparimin e Tropojes.Per cilesi te veçanta njerezore, aktivizem e ndershmeri te deshmuar ne komunitet".

2. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" z.**Lulzim Idriz Logu**, *me motivacion* "Per kontribut te shenjuar personal e familjar ne perparimin dhe modernizimin e arsimit ne Tropoje.Per punen e tij krijuese e organizuese ne promovimin e vlerave te spikatura kulturore e artistike te Vendlindjes tone".
3. T'i japë titullin "Qytetar Nderi" **z.Feriz Hamez Lamaj** me motivacion "Per kontribut te veçante ne ngritjen e cilesise se arsimit dhe kultuter nder vite ne Tropoje.Ka deshmuar aftesi te spikatura si drejtues me aftesi organizative dhe intelektuale".Ai vijon te jete aktivist dhe nje zë i forte i Vendlindlindjes ne migracion"

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Rexhe BYBERI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... TROPOJE

# Jetëshkrim

## Informatat Personale

| | |
|---|---|
| Emri / Mbiemri | Lulzim Logu |
| Adresa | Bajram Curri / Lagjia 'Partizani' / Pallati i Ri |
| Telefoni | Cel : 0682357769<br>Fiks:021322289 |
| E-mail | lulzimlogu@yahoo.com |
| Nacionaliteti | Shqiptar |
| Data dhe vendi i lindjes | 08/07/1960 |
| Gjinia | Mashkull |

**Punësimi i dëshiruar** **Specialist në sektorin e Kualifikimit dhe Cilësisë, Zyra Arsimore Tropojë**
**Ekspert në procese formimi.**

## Eksperiencat e punës

| | |
|---|---|
| Data | 2005-2015 |
| Pozita që është ushtruar | Mësues |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Mesimdhenie,edukim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | Drejtoria Arsimore Bajram Curri |
| Lloji i biznesit ose sektorit | Shkolla e Mesme 9-vjeçare : 'Jaho Salihi' , Bujan / Sektori Arsimor |
| Data | 2004-2005 |
| Pozita që është ushtruar | Drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar Fierzë |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Organizim, drejtim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | Drejtoria Arsimore Bajram Curri |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Shkolla e Mesme e Bashkuar Fierzë / Sektori Arsimor |
| Data | 1997-2004 |
| Pozita që është ushtruar | Inspektor arsimi |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Inspektim,trajnim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | Drejtoria Arsimore Bajram Curri |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Sektori Arsimor |
| Data | 1984-1997 |
| Pozita që është ushtruar | Mësues i profilit biokimi |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | Drejtoria Arsimore Bajram Curri |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Shkolla e Mesme 9-vjeçare : 'Jaho Salihi' , Bujan |

| | |
|---|---|
| Data | 2000 |
| Pozita që është ushtruar | Bashkëpunëtor dhe konsulent I Fondacionit 'SOROS' në Projektin: 'Tropoja 2000' |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Koordinim, mbledhje informacioni, projektim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | SOROS / Tirane |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizate Joqeveritare |
| | |
| Data | 1998-2002 |
| Pozita që është ushtruar | Kordinator i CRS ALBANIA për Tropojën |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Trajnim,keshillim, organizim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | CRS ALBANIA / Tiranë |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizatë Joqeveritare/Përfshirje e komunitetit në edukim |
| | |
| Data | 2003 |
| Pozita që është ushtruar | Kordinator i IDN për Tropojën |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Trajnim, organizim,menaxhim projekti |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | IDN |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizatë joqeveritare /Përfshirje e komunitetit, transparencë publike |
| | |
| Data | 1999-2009 |
| Pozita që është ushtruar | Kordinator i IFES , Trajner i zgjedhjeve. |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Trajnim, monitorim |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | IFES / KQZ , Tiranë |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizatë qeveritare/Monitorim i zgjedhjeve |
| | |
| Data | 2000-2013 |
| Pozita që është ushtruar | Drejtues dhe themelues i shoqatës: ' SHKD' dega Tropojë |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Monitorim,trajnim,edukim |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizate joqeveritare |
| | |
| Data | 2000-2013 |
| Pozita që është ushtruar | Bashkëthemelues i Shoqatës Mjedisore: 'ALPIN' , anëtar i bordit drejtues |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Trajnim, organizim projektesh mjedisore |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizate joqeveritare / Sektori : Mbrojtje e Mjedisit |
| | |
| Data | 2009 |
| Pozita që është ushtruar | Kordinator i Projektit : ' Të Drejtat e Fëmijëve' |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Trajnim, menaxhim projekti |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | CCF/ Partner for Children / Tirane |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Organizatë joqeveritare /Edukim |
| | |
| Data | 2000-2015 |
| Pozita që është ushtruar | Kryetar i Klubit të Shkrimtarëve dhe Artistëve Tropojë |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Promovime, botime |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | Tropoje |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | Klub letrar artistik |
| | |
| Data | 2014-2015 |
| Pozita që është ushtruar | Kordinator |
| Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë | Ngritja dhe funksionimi i Klubeve mjedisore |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit | QIZHDK |
| Lloji i biznesit dhe sektorit | BE-Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit në zonat ndërkufitare |

## Edukimi dhe Trajnimet

| | |
|---|---|
| Data | 1981-1986 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Mësues i profilit biokimi |
| Aftesitë profesionale të përfituara | Mesimdhenie, komunikim, edukim |
| Emri dhe lloji i organizates që ka ofruar edukimin dhe trajnimin | Universiteti 'Luigj Gurakuqi', Shkodër |
| Data | Mars 2003 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikate për pjesmarrje te suksesshme ne Projektin:" Edukimi i te Drejtave të Njeriut në shkollë" |
| Aftesitë profesionale të përfituara | Organizative, komunikative |
| Emri dhe lloji i organizates që ka ofruar edukimin dhe trajnimin | UNESCO dhe ISP |
| Data | Gusht 2002 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë për përfshirje aktive ne Projektin:" Atësitë për jetën" |
| Aftesitë profesionale të përfituara | Thellim ne informacione te reja, teknika komunikimi |
| Emri dhe lloji i organizates që ka ofruar edukimin dhe trajnimin | UNESCO dhe MASH |
| Data | 2000 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë për kontribut ne Projektin për mbrojtjen dhe ndergjegjesimin e nxenesve nga UXO 2000 |
| Aftesite profesionale te perfituara | Organizim, edukim |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | UNICEF & CARE INTERNATIONAL |
| Data | 2005 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë: SKUADRA 2000 |
| Aftesite profesionale te perfituara | Ndjekje dhe perfundim i suksesshem i Kursit:" Ngritje kapacitetesh per Organizatat Joqeveritare dhe Jofitimprurëse" |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | Skuadra 2000 |
| Data | 2007 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë për perfundimin me sukses te Kursit te Plote: 'Cikli i menazhimit të një Projekti' |
| Aftesite profesionale te perfituara | Organizim , menazhim , planifikim , drejtim projekti |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | OSCE & ESDC & UNDP |
| Data | 2005 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë për pjesmarrje aktive në Projektin :" Java e të mësuarit për gjithë jetën" |
| Aftesite profesionale te perfituara | Komunikative, organizative |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | PARSH & CIVET |
| Data | 2006 |
| Aftesite profesionale te perfituara | Teknika anketuese per marrje informacioni |
| Emri dhe lloji i organizates | USAID & LGDA |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Çertifikatë për pjesmarrje në projektin : 'Anketimi qytetar 2006' |

| | |
|---|---|
| Data | 2009 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Certifikate për pjesmarrje dhe kontribut ne Projektin : 'Zhvillimi i kujdesit për fëmijërinë e hershme' |
| Aftesite profesionale te perfituara | Teknika te reja komunikimi, organizim projektesh |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | CCFA |
| Data | 1998 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Certifikate : ' Shkrimi dhe menaxhimi i projekteve' |
| Aftesite profesionale te perfituara | Kualifikim per projektimin , organizimin , menaxhimin dhe drejtimin e projekteve |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | CRS ALBANIA |
| Data | 2007 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Certifikate për pjesmarrje në projektin: 'Ngritja e kapaciteteve te komuniteteve lokale |
| Aftesite profesionale te perfituara | Teknika te ngritjes se grupeve komunitare |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | IDN |
| Data | 2009 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Diplomë: Lidhja:" Pegasi" për kontribut në Simpoziumin Nderkombëtar Pegasi 2009" |
| Aftesite profesionale te perfituara | Aftesi komunikative |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | Lidhja Pegasi |
| Data | 2009 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | Diplomë : 'Komunikim kulturor" |
| Aftesite profesionale te perfituara | |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka ofruar edukimin dhe trajnimin | Klubi: 'Kafeja e Ideve' Athine 2009 |
| Data | 2000-2013 |
| Titulli i fituar i kualifikimit | 1. Certifikate për perfundim të Programit Trajnues për Numerimin e Votave ,<br>2. Certifikate per përfundimin e Programit të Trajnimit të trajnuesve të KZQV_ ve.<br>3. Certifikate për përfundimin e Programit të Trajnuesve për teknikat dhe procedurat e zgjedhjeve" |
| Aftesite profesionale te perfituara | Teknika trajnuese dhe monitoruese |
| Emri dhe lloji i organizates qe ka orfuar edukimin dhe trajnimin | KQZ & IFES |

**Aftësitë personale dhe kompetencat**

| | |
|---|---|
| Gjuha e nënës | Shqip |
| Gjuhë të tjera | |
| Vetë – vlerësimi | |

| | Të kuptuarit | | Të folurit | | Shkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| *Sipas nivelit europian (*)* | Dëgjimi | Leximi | E folur interaktive | E folur produktive | |
| **Anglisht** | B2 | B2 | B2 | B2 | B2 |
| | | | | | |

| | |
|---|---|
| Aftesitë shoqërore | Komunikim aktiv, përfshirje dhe tolerancë ne drejtim te kontributit social |
| Aftesitë organizative | Aftësitë për planifikim, organizim dhe menaxhim në përgjithësi |
| Aftësit kompjuterike | Kurs i plotë i kompjuterit : Word , Excel , Power Point , SPSS / " COMPUTER FAITHE " |

Aftësitë letrare artistike | Poet, shkrimtar , drejtues i Shoqates së Shkrimtareve dhe Artisteve Tropoje

LIBRA TE BOTUAR:

1. " KOHEN E ENGJELLIT " POEZI; 1999, TIRANE
2. " HIRI" POEZI, 2002; TIRANE
3. " PINOKU I QYTETIT MAGJIK" ,POEZI PER FEMIJE; 2002
4. " ENCIKLOPEDIA E VOGEL, TROPOJA" 2008; TEKST SHKOLLOR
5. " KOHA VDES SI ZEMER" POEZI, 2009, TIRANE
6. " AKOMA HIRI IM" POEZI, 2009
7. " KUJTIMET E UJQERVE GRI" TREGIME, 2009
8. " KRISHT I HARRUAR" POEZI 2011
9. " PIKE MBI I' " POEZI ;2013
10. " ANTOLOGJI E POETEVE TE MALESISE SE GJAKOVES" POEZI; 2013
11. "FRYME NE NJE KUTI" 2014
12. "PIKËNISJA E MËKATIT" 2025

PERKTHYER NE GJUHEN ANGLEZE:

LIBRI: " KOHA VDES SI ZEMER"
LIBRI: " KRISHT I HARRUAR"

LIBRA NE DORESHKRIM:

1. " BOTA-NJE FJALE QE DHEMB" PUBLICISTIKE
2. " NE QIELL NUK VDISET" PUBLICISTIKE
3. " PERSIATJE PEDAGOGJIKE" ESE STUDIME

Patent Shoferi | Zotëroj patentë shoferi / klasi B

Nr. 4960 Prot.
Dt. 20/10/2025

**Rrustem Bajram Mulosmani**

Lindur me 1 shkurt 1926 ne fshatin Bujan te Rrethit Tropoje , pasardhes i Heroit te Popullit Mic Sokoli

*Shkollimi* :Ka kryer shkollen e mesme .Ne vitin 1957 - 1958 ka kryer shkollen per drejtues ne kooperativat bujqesore.

*Karriera* : Pas mbarimit te shkolles me rezultate shume te mira , punon 2 vjet llogaritar i koop. Bujqesore Bujan . Ne vitin 1960 zgjidhet kryetar i Kooperatives Bujqesore Bukove. Ne vitin 1965 zgjidhet kryetar i Kooperatives Bujqesore Valbone . Me pas kryetar i Kooperatives Bujqesore Rrogam i Shales. Me bashkimin e kooperativave , zgjidhet kryetar i Kooperatives Valbone Rrogam . Ne vitin 1970 zgjidhet kryetar i keshillit te bashkuar per kooperativat Dragobi , Valbone , Rrogam , Cerem , per nje ju legjislature . ( 3 vjet ) Ne legjislaturen tjeter u zgjodh kryetar i keshillit te bashkuar ne Ndermarjen Bujqesore te rrethit Tropoje . Me pas ka qene pergjegjes sektori ne Bujan dhe karrieren e mbylli ne Ndermarjen Bujqesore .

Ne gjithe karrieren e tij te gjate eshte shquar per aftesi shume te mira si organizator e drejtues . Ne vitet e para qe drejtoi disa kooperativa bujqesore , realizoi ne kooperativat qe drejtoi vleren e dites se punes me te larte nga kooperativat tjera te rrethit . Ka spikatur vecanerisht drejtimi gjate viteve ne Valbone , qe megjithese kooperativa kishte nje siperfaqe teper te kufizuar toke are , Rrustemi ngre nje sharre per kooperativen per carje derrasa dhe artizanat per prodhime druri si dhe rriti numrin e deleve e dhive per prodhim bylmeti e mishi. Me kete organizim shleu gjithe detyrimet financiare te kooperatives dhe realizoi diten e punes 120 lek , e vecante kjo per Rrethin e Tropojes .

Rrustem Mulosmani , kudo ku drejtoi u shqua jo vetem per drejtim te suksesshem , po dhe per mardhenie shume te mira me popullin . Kudo ku punoi la mbrapa opinionin masiv te njerezve si drejtues i zoti dhe burre i mire , i ndershem , i sinqerte , i ndjeshem per hallet e problemet e njerezve .

Rrustem Mulosmani diti te krijonte frymen e kolektivitetit te njerezve , kudo ku punoi , dhe ky ishte celesi i suksesit te tij si drejtues .

Ne vitin 1969 Rrustem Mulosmani eshte dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me medaljen : " Per pune te shquar ne ekonomine bujqesore "

Ne vite eshte nderuar me Flete Nderi per pune cilesore e ndergjegje te larte .

Gjate viteve ne pension , Rrustem Mulosmani ka qene aktiv ne veprimtarite patriotike e historike me Organizaten e Veteraneve te Rrethit si dhe ne veprimtari patriotike ne Prishtine , Prizren e Ferizaj .

Rrustem Mulosmani eshte nderuar nga Komiteti Kombetar I Organizates se Veteraneve me titullin e larte " Nderi i Organizates se veteraneve te LANÇ "

Rrustem Mulosmani ka rritur e shkolluar me arsim te larte 6 femije dhe familja e tij dallohet per integritet moral e shoqeror dhe nuk kane asnje rast konflikti ne kohet e trazuara te viteve te fundit

20/10/2025

Nr 5036 Prot
Dt. 22/10/2025

Kerkese

Drejtuar;Keshillit te Bashkise Tropoje.

Lenda:Kerkese per shpalljen "Qytetar Nderi" te z.Feriz Lamaj.

Te nderuar keshilltare!

Ne vijim te tradites tone te perbashket per nderimin e personaliteteve te Tropojes te cilet kane lene gjurme te dukshme kontributi ne Vendlindjen tone ju propozoj shpalljen "Qytetar Nderi" te z.Feriz Hamez Lamaj.

Feriz Lamaj i perket nje brezi te nderuar intelektuale mesimdhenesish dhe edukatoresh te cilet e radhiten Vendlindjen tone ne pararojen kombetare te zhvillimit te aresimit dhe kultures nder dekada.Z.Lamaj rrjedh nga nje familje patriotike,bujare dhe fisnike e Malesise se Gjakoves.Ai u aresimua dhe u kualifikua me rezultate te shkelqyera per kohen.Formimin e tij inteletual,shkencor e shoqeror ai e investoi ne Tropoje gjate gjithe karrieres se tij.Si mesues e per shume vite si drejtues i arsimit dhe kultures ne rrethin tone ai arriti rezultate te dukshme si dhe demonstroi cilesi te veçanta organizimi.

Edhe ne emigracion ne SHBA ku jeton prej vitesh z.Feriz Lamaj ka treguar aktivizem model ne komunitetin shqiptar duke lobuar per çeshtjen kombetare e ne veçanti per Vendlindjen tone dhe perparimin e saj.

Mendoj se nderimi dhe pergjithesimi i figures se z.Feriz Lamaj eshte gjithashtu nje kujtese ne edukimin arsimor,kulturor dhe patriotik te brezit te ri.

Bashkengjitur po ju dergojme dhe motivacionin shoqerues te nderimi "Qytetar Nderi" te z.Feriz Lamaj.

Motivacioni "Per kontribut te veçante ne ngritjen e cilesise se arsimit dhe kultuter nder vite ne Tropoje.Ka deshmuar aftesi te spikatura si drejtues me aftesi organizative dhe intelektuale .Ai vijon te jete aktivist dhe nje zë i forte i Vendlindlindjes ne migracion"

Me respekt: Rexhe Byberi

Drejt. Keshillit
Znj Flora Nderi
20/10/2025

Nr 5629 Prot
Dt. 20/11/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TROPOJË**
**NJËSIA ADMINISTRATIVE LEKBIBAJ**

Nr 205/1 Prot

Lekbibaj, me 17.11.2025

Lënda: Propozim për dhënie titull nderi

Kryetarit të Bashkisë Tropojë

Bazuar në ligjin Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" Neni 66 shkronja "g" "*i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial*" u propozojmë për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për z. Zymer Isuf Mulaj (pas vdekjes).

Bashkangjitur do të gjeni jetëshkrimin.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Administratori
Besad Ndoja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE LEKBIBAJ BASHKIA TROPOJË

Komisionit Vlerësimit Figurave 20/11/2025

Sekretarit Këshillit 20/11/2025

Sheshi Azem Hajdari Qyteti Bajram Curri email: info@tropoje.gov.al

Nr. 205 Prot
Dt 17.11.2025

Tirane me 20.10.2025

**Drejtuar:** Njësisë Administrative Lekbibaj, Tropojë.

**Ne vemendje:**

**Lënda:** Për vlerësim kontributi (në anën morale).

I nderuar Administrator i Njësisë Administrative Lekbibaj, Tropojë!

Unë jam Gëzim Mulaj, i biri i Zymer Isuf Mulaj dhe i Zojë Mulaj.
Kam lindur më 03/06/1973, në Mulaj, Lekbibaj, Tropojë.
Në moshën time 7 vjeçare më vdiq babai dhe nuk trashëgova nga goja e tij pjesë të jetës së tij, por me kalimin e viteve më ra të dëgjoj nga bashëmoshatarët e tij mbi veprimtarinë e jetës së babait tim.
E mira do ishte tu servirja në tavolinë dokumente të studimeve shkencore apo shkrime të studiuesve historianë të zonës, apo të Tropojës, por edhe ato shkrime të cilat janë bërë pas viteve tetëdhjetë, për fat të keq nuk gjenden.
Shkurtimisht dua tu sqaroj rreth veprimtarisë së babait tim:
Ka lindë më 15/10/1903 në Mulaj, Lekbibaj, Tropojë, dhe ka vdekë më 27/04/1981. Në moshën 21 vjeçare, i është përgjigjë thirrjes që është bërë në atë kohë nga Bajram Curri, i stacionuar (sipas babës tim, thënë nga goja e tijë në vitin 1980) në shtëpinë e Shpënd Bali Bisheva (një shtëpi dy katëshe në fshatin Koçanaj), dhe ka marrë pjesë aktive në çeshtjen e bashkimit të trojeve Shqiptare kryesisht në disa zona të Maqedonisë (ku kishte popullsi shqiptare ) dhe në Kosovë.
Mbas rënies së Bajram Currit babai im u dënua si bashkëluftëtar i Bajram Currit me tre vite burg, dënim të cilin e vuajti në burgun që ndodhej në Sallsatik, mbi Krujë.
Nga viti 1981 deri në vitin 1989, kanë shkruar e botuar disa herë studiuesi Fran Vukaj dhe historiani (i ndjerë ) Dod Progni, në gazetat: Zëri i Popullit, Bashkimi, Revista Ylli, Studime Historike (ky i fundit organ i Akademisë së Shkencave), ku në disa nga këta artikuj shkruhej për veprimtarinë e babait tim (të ndjerë) Zymer Isuf Mulaj.
Në njërin nga këta artikuj të botuar është shoqëruar edhe me një foto të babës tim me Bajram Currin, foto e cila sëbashku me mbi 600 të tjera është nxjerrë nga Fototeka Marubi, dhe kjo që u botua në gazetë gjendej në njërën nga stendat në Muzeun e qytetit Bajram Curr derisa u dëmtuan dhe humbën.
I nderuar Administrator i Njësisë Administrative Lekbibaj, Bashkia Tropojë (sëbashku me stafin tuaj):
Me kaq sa u shkruajta në lidhje me veprimtarinë e babës tim, miqësisht dua tu drejtohem me kërkesën për vlerësim moral (mbas vdekjes), kërkesë të cilën mbasi ju të dakortësoheni do e paraqisni për miratim në Këshillin e Bashkisë Tropojë.
Mbetem shpreseplotë se kërkesa ime do shqyrtohet në takimin tuaj të rradhës. Bashkëngjitur kërkesës po u dërgoj Librezën Ushtarake (fotokopje), ku vërtetohet me shkrim aktivizimi për periudhën dy-vjeçare 1924-1926, dhe Çertefikatën familjare të vitit 1980.

Me shum respekt për secilin nga ju!

Gëzim Zymer MULAJ.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Bashkia** Tropojë

**Njësia administrative** Lekbibaj 303

**Zyra e Gjendjes Civile** 303

Datë: 15.10.2025

# CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, Fshati Qeresh Mulaj nr.18 faqe 35 me reference vërtetohen të dhënat e mëposhtme

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Datëlindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Zymer MULAJ | Isuf | Lulë | M | Kryefamiljar | 15-10-1903 | I/e martuar | Qeresh Mulaj, Tropoje | Shqiptare | ---------- |
| 2. | Zojë MULAJ | Pjetrush | Prëndë | F | Bashkëshorte | 07-03-1931 | I/e martuar | Curraj Eper, Tropoje | Shqiptare | ---------- |
| 3. | Shiqere MULAJ | Zymer | Zojë | F | E Bija | 27-12-1970 | Beqar/e | Qeresh Mulaj, Tropoje | Shqiptare | ---------- |
| 4. | Gzim MULAJ | Zymer | Zojë | M | I Biri | 03-06-1973 | Beqar/e | Qeresh Mulaj, Tropoje | Shqiptare | ---------- |
| 5. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 6. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 7. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 8. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 9. | ----------------- | | | | | | | | | |
| 10. | ----------------- | | | | | | | | | |

Kjo certifikatë lëshohet për Dokument

gjendja e familjes sipas vitit 1980

**Nëpunësi i Gjendjes Civile**

Agim Ndreepecaj

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date 2025/10/15 12:37:03 +02'00'
a22adf7771554 16db3b0eba4ec83747a

Shënim : ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIJA E MBROJTJES POPULLORE

★

# BILETA USHTARAKE

№ 204352 Seria L

Fotografija

1. Emri ZYMER

Atsija ISUFI

Mbiemri MULAJ

Vula

PËRSHKRIMI PERSONAL

2. Naltësija
3. Fytyra
4. Hunda
5. Flokët
6. Sytë
7. Goja

Firma Personale

Shef' i Degës Ushtarake
(Firma)

19

Qyteti

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRIS
MINISTRIJA E MBROJTJES POPULLORE

★

BILETE - USHTARAKE

Nr. 004872 Serija

1. Zymer
(Emri)

Isufi Mulaj
(Atsija Mbiemri)

2. E dhënë nga Dega Ushtarake

Shef' i Degës Ushtarake
(Firma)

Vula

Shef' i Seksionit I-rë
(Firma)

19

**Kreu I I.**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | NESU... NESU... NESU... NESU... | 2. Emri |
| | | Atsija Mbiemri |
| 3. Grupi Evid. | | 5. Viti i lindjes 1903 |
| 4. Perberja | | |
| 6. Grada | | |
| 7. Arma dhe specialiteti ushtarak | NESU dhe Titulli | NESU dhe Titulli |
| | Pergjegjesia e Klasifikuar | Përgjegjësia e Klasifikuar |
| 8. Hyrja në Parti | | 10. Profesioni |
| | | specialiteti |
| Shkolla | Përgjithshme | 11. Kombësia |
| | | 12. Gjuha amtare |
| | Spec. | 13. Çfarë gjuhe zotnon |
| | Ushtar. | |
| | Polit. | |

**SHENIME SPECIALE**

Del nga detyrimi ushtarak për arsye moshe si [illegible] ligjit. 13-I-959

Shefi Degës ushtarake

Kapiten i [illegible]

Grupi i gjakut:

Doktori

I aftë për shërbimin Ushtarak
(Kur dhe cili komisjon e vizitoi)

**Kreu II.**

**Shërbimi Ushtarak i vërtetë**

1. U thir
Qyteti
2. Koha e thirjes Viti 19
3. U transportua

4. U lirua dhe u hoq nga efektiva
në bazë
5. Kryerje e detyrës n'ushtrinë Popullore Shqiptare

| Emertimi Reparteve Ushtarake Pergjegjesia dhe specialiteti | Koha (Viti, Muaji) |
| --- | --- |
| | 19 |
| 6. Mbrrijti dhe u caktua<br>U lirua ne baze t'urdherit Ministris Mbrojtjes Popullore<br>Nr. prej | |

Vula

Shef' i degës Ushtarake
(Firma)